



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Legjislatura e III-të  
Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport  
Mbledhja Nr. 24  
Prishtinë, dt. 21.04.2009  
Salla Nr. C - 203 ora 13,00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Veliu, Drita Kadriu, Gani Buçinca, Adem Hajdaraj, Arsim Rexhepi, Donika Kadaj-Bujupi, Heset Cakolli dhe Mark Krasniqi.

**Munguan:** Memli Krasniqi, Enis Kervan dhe Dragan Dimiq

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Në mbledhje prezantuan: përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësuesi nga presidenca dhe mediat e Kuvendit.

Mbledhjen e udhëhoqi **Agim Veliu**, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

**Rend dite**

- 1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.**
- 2. Diskutim i Raportit të anëtarëve të Komisionit nga vizita në Prizren**
- 3. Përmbushja e planit të punës për tre mujorin e parë,**
- 4. Raport i Komisionit për Organet e pavarura - Këshillat.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.  
Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

### **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Kryesuesi, konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar me disa plotësime.

### **2. Diskutim i Raportit të anëtarëve të Komisionit nga vizita në Prizren**

**Kryesuesi** i Komisionit kërkoi Raport me shkrim të përgatitur nga anëtarët e komisionit në përbërje; Donika Kadaj Bujupi, Drita Kadriu, Arsim Rexhepi dhe Enis Kervan.

**Donika Kadaj-Bujupi** – tha se së shpejti do të prezantohet Raporti me shkrim para komisionit lidhur me të gjitha konkluzionet rreth shkeljes së Konkursit të shpallur nga DKA –Prizren.

Ajo tha se në takimin me kryetarin e komunës në Prizrenit, kemi diskutuar për Rekomandimin e hartuar nga Komisioni dhe kemi kërkuar argumente shtesë për vendimin e Komunës së Prizrenit për shpalljen e konkursit për 30 drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të cilëve ende i kanë skaduar kontratat .

Në vazhdim theksoi se në takimin me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme janë marrë opinione të ndryshme, akuza dhe kundër akuza lidhur me konkursin e shpallur nga DKA - Prizren. Qëndrimet e tyre ishin që ne si Komision të kërkojmë nga Qeveria dhe MASHT që sa më shpejtë të ndërmarrin masa për zgjedhjen e kësaj çështjeje.

Ajo konstatoi se si Komision për Rekomandim t'i procedojmë këto pika;

- është shkelur Ligji për Arsimin Lokal;

- është shkelur Rregullorja për Shërbyesit civil,

Ligji nuk mund të ndryshojë për interesa politike, sipas dëshirave të Qeverisë.

Ajo propozoi që KPM-ja dhe Prokuroria të marrin vendim të prerë për zgjedhjen e çështjes së Konkursit të shpallur nga DKA-së Prizren pasi është shkelë Rregullorja për Shërbyes civil dhe ende nuk është anuluar Konkursi i DKA-së Prizren i cili është në kundërshtim me Ligjin, .

**Arsim Rexhepi** – tha se në bazë të vizitës në Prizren kemi konstatuar se kërkesat e drejtoratit të Komunës janë që të përshpejtohet procesi i emërimit dhe i zgjedhjes së drejtorëve të rij komfor konkursit të shpallur nga DKA –Prizren me datën 23.03.2009.

Ai konsideron se me shpalljen e konkursit nga DKA në Prizren janë shkelë dy fundamente, ai human dhe ai ligjor. Kundër argumentet e paraqitura nga drejtorati i Komunës së Prizrenit paraqesin shkelje flagrante të Ligjit.

Ai konstatoi se në bazë të mekanizmave tona si Komision, duhet të fokusohemi për zgjedhjen e çështjes së konkursit me qëllim të mbrojtjes të të drejtave të drejtorëve aktual. Për këtë çështje mendojë se do të duhej të ftohet Ministri në interpelancë.

**Heset Cakolli** - tha se pasi nuk e kemi raportin me shkrim nga vizita në Prizren dhe nuk kemi informata sipas pikës tre të Rekomandimit të komisionit , propozoi që kjo pikë të debatohet në mbledhjen e radhës.

Mendon që MASHT-i duhet ta verifikojë procesin e konkursit të shpallur nga DKA-Prizren, dhe komisionit ti dërgojë informatë lidhur me atë se cilat janë shkaqet që kanë ndikuar në shpalljen e konkursit për këto vende pune.

Ai mbështetë qëndrimin se drejtorët aktual ende kanë kontratë valide dhe përkrahë zbatimin e Ligjit dhe të Udhëzimit Administrativ.

**Drita Kadriu** – theksoi se ka kërkuar nga stafi mbështetës dhe kryetari që mbledhja të shtyhet për një ditë tjetër, por kjo kërkesë e saj nuk është realizuar.

Vizita e cila është bërë në Prizren realisht percepton situatën se janë bërë dy taborë politike. Argumentet e dy taborëve ishin në kundërshtim me njëra tjetrën dhe për këtë neglizhencë të tyre nuk shohë paraqitje të ndonjë humanizmi. Mendon se ata të cilët kanë shkaktuar këtë problem politikë, të njëjtit ta bëjnë zgjedhjen politike. Ajo mbështetë faktin se ekzistojnë procedurat për shpalljen e konkursit me ç'rast konkursi i fundit nga DKA – Prizren, paraqet shkelje të Ligjit.

Propozoi se si komision të distancohemi nga shkresat e marra dhe më tej të dalim me një qëndrim konkret.

Grupit punues i cili ka dalë para mediave, në mënyrë jo transparente paraqet ulje të dinjitetit politikë.

**Kryetari**- tha se mbledhja nuk ka qenë urgjente por është thirrur në formë të rregullt dhe nuk kishte arsye që të shtyhet. Ai theksoi se ka caktuar rendin e ditës meqë pika lidhur me Raportin e Komisionit për Organet e pavarura - Këshillat, duhet përfunduar në afat të paraparë.

Lidhur me çështjen e konkursit, komisioni ka shqyrtuar anën ligjore dhe kemi marrë qëndrim që të mos merremi me kualifikime, se argumentet politike nuk janë në interes të komisionit.

Ai propozoi që Raporti t'i dorëzohet edhe KPM-së -Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës dhe gjykatave sepse është shkelë Rregullorja për Shërbyes Civil 2001.

Si Komision do të dalim me konstatim se konkursi i shpallur nga DKA në Prizren është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin Lokal dhe shkeljen e Udhëzimit Administrativ 03/2009 të datës 23.03.2009.

**Mark Krasniqi** - diskutoi se nuk duhet të bazohemi në interesa politike por vlerësoi se duhet të dalim para mediave se kush e shkelë Ligjin duhet të dënohet.

Ai konstatoi se shpallja e konkursit nga DKA– Prizren paraqet shkelje flagrante të Ligjit.

**Adem Hajdaraj** - mendon se shpallja e konkursit nga drejtorati i DKA-së në Prizren është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin Lokl. Ai tha se në Komunën e Prizrenit nuk punojnë vetëm drejtorë të LDK-së dhe PDK-së por i përkasin të gjitha partive politike. Si komision duhet të jemi unik dhe të angazhohemi që së bashku me Kuvendin Komunal të Prizrenit të anulohet konkursi i shpallur me datës 23.03.2009.

**Gani Buqinca** –theksoi se lidhur me konkursin e shpallur nga DKA nuk bëhet fjalë për çështje humane. Në bazë të kompetencave që ka komisioni duhet të nxjerrë Rekomandime e jo të merremi me rolin e Prokurorit apo të Gjykatës.

Mendon se një vendim mbron aspektin juridik dhe ai nuk mund të jetë mbrojtës për pa aftësinë e drejtorëve. Kjo çështje duhet të shikohet nga aspekti objektiv, të konstatohen sa po zbatohet Ligji dhe për faktin se ekzistojnë kontratat valide duhet të kërkojmë të merren masat e nevojshme për zbatimin e tyre.

Ne si komision duhet të dalim me qëndrim se konkursi është joligjor dhe duhet të anulohet. Ai konstatoi se është shkelë Ligji për Arsimin Lokal. Njëkohësisht duhet të kërkohet nga MASHT-i informatë shtesë se sa po zbatohet Ligji dhe Udhëzimi Administrativ. Mendon se për këtë çështje duhet të ndërhyjë edhe Qeveria.

**Kryesuesi** - tha se Komisioni në mbledhjen e kaluar ka nxjerrë rekomandim lidhur me këtë çështje por nuk ka marrë informatë nga MASHT. Anëtarët e komisionit kanë vizituar Komunën e Prizrenit me qëllim të informimit lidhur me këtë çështje.

Kryetari konstatoi se pas debatit të anëtarëve të komisionit lidhur me konkursin e shpallur nga DKA në Prizren për vendet e punës drejtor dhe zëvendës drejtor në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Prizrenit, është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin Lokal dhe të Udhëzimit Administrativ 03/2009 të datës 23.03.2009 dhe miratoi këtë;

Kryesuesi -tha se komisioni merr vendim që Rekomandimet e datës 4.07.2009 edhe një herë të përcillen në MASHT që të ofrojnë informata shtesë.

### **R e k o m a n d i m**

1. Komisioni konstatoi se konkursi i shpallur nga DKA në Prizren për vendet e punës drejtor dhe zëvendës drejtor në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Prizrenit është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin Lokal.
2. Komisioni kërkon informatë nga kryetari i Kuvendit Komunal të Prizrenit lidhur me kërkesën për anulimin e konkursit, sipas pikës 2 të Rekomandimit të Komisionit të datës 7.4.2009 për drejtorë dhe zëvendës drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme i shpallur me datë 19 dhe 23.03.2009.
3. Komisioni konstaton se edhe përkundër kërkesës nga MASHT sipas pikës 3 të Rekomandimit të Komisionit të datës 7.04.2009 nuk ka marrë asnjë informacion për zbatimin e Ligjit dhe të Udhëzimit Administrativ 03/2009 të datës 23.03.2009.
4. Komisioni kërkon nga MASHT-i përsëri informatë për zbatimin e Ligjit dhe të Udhëzimit Administrativ 03/2009 të datës 23.03.2009.

### **3. Përmbushja e planit të punës për tre mujorin e parë**

**Kryesuesi** – konstatoi se komision lidhur me këtë pikë ka paraparë disa prioritete të punës;

- shqyrtimi dhe amendamenti i Projektligjeve që janë në kompetencë të Komisionit
- monitorimit i zbatimit të Ligjeve në praktikë, dhe
- prioriteti i tretë parashih vizitat në Institucione brenda dhe jashtë vendit.

Sa i përket prioritetit të parë, theksoi se me strategjinë legjislative kanë qenë të parapara të vijnë nga Ministria e Kulturës këto Projektligje; P/Ligji për Sponzorime; P/Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinës dhe P/Ligji për Mërgatën.

Komisioni konstatoi se P/Ligjet nuk kanë arritur nga Qeveria. për çështjen e implementimit të Ligjeve është bërë monitorimi i Ligjit për të Drejtat të Autorit dhe sa i përket vizitave, është bërë vizita në Prizren.

**Donika Kadaj** mendon se vizitat jashtë vendit janë praktikë e mirë se merren opinione se si zbatohen ligjet e Arsimit të ulët dhe të lartë në vendet e zhvilluara. Ajo tha se me Enis Kerven kanë kontaktuar me Ambasadën Turke dhe oferta e tyre ka qene për 6 anëtarë, ndërsa kemi propozuar që numri i anëtarëve të shtohet. Për afat kohor ka mbetur të caktohet nga komisioni.

**Drita Kadriu** – propozoi që komisioni të vizitoi Teatrin Kombëtarë, se drejtori i ri ka dhënë entuziazëm të shikueshmërisë.

**Arsim Rexhepi** – propozoi që komisioni të përpilojë një tabelë kalendarike që në të ardhmen të bëhen vizita në departamente në të gjitha Komunat. Këto vizita do të ofrojnë ndihmë Komunave që të mos përsëritet shkeljet eventuale të Ligjeve.

#### **4. Raport i Komisionit për Organet e pavarura - Këshillat.**

**Kryesuesi** - konstatoi se komisioni miratoi Raportin e Komisionit për Organet e pavarura - Këshillat dhe murr qëndrim që i njëjti të dorëzohet Kryesisë së Kuvendit për shqyrtim të mëtejme.

Kryesuesi kërkoi që për mjetet e dedikuar për komisionin të hartohet një shkresë sipas të cilës do të shpenzohen këto mjete.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 15:40

Kryetari i Komisionit,  
Agim Veliu